# Busolla ideologjike e Kosovës

## Hartë e orientimit të partive politike

Instituti Demokraci për Zhvillim
| Seria: Partitë Politike | Nr. 7 | Prishtinë, 2014 |

Democracy for Development
Demokraci për zhvillim
Demokratija za razvoj

# Busolla ideologjike e Kosovës

## Hartë e orientimit të partive politike

Prishtinë, nëntor 2014

- - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - -

Copyright © 2014. Demokraci për zhvillim (D4D).

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Përveç për citate të pjesëve të shkurtra për qëllime të kritikës dhe shqyrtimit, asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në një sistem arkivimi, ose të transmetohet në çfarëdo forme apo çfarëdo mjeti elektronik, mekanik, fotokopjues, regjistrues ose tjetër, pa lejen paraprake të D4D.

Studimi është përgatitur nga:

Leon Malazogu dhe Brenna Gautam

me kontribut nga:

Rezarta Delibashzade, Ngadhnjim Halilaj.

- - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - -

# Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive, 4

I. Hyrje, 7
*Supozimet, 10*
*Qëllimi, 12*
*Analizë e literaturës, 13*
*Metodologjia, 16*

II. Përshkrimi i profileve kryesore ideologjike, 20
*Socialistët, 20*
*Të majtit, 21*
*Socialdemokratët, 22*
*Liberalët, 23*
*Autoritarët, 23*
*Nacionalistët, 24*
*Libertarianët, 25*
*Të djathtit, 26*
*Konservatorët ,26*

III. Një pasqyrë e shkurtër e skenës partiake, 28
*PDK, 28*
*LDK, 29*
*AAK, 30*
*VV, 30*

IV. Orientimi ideologjik një-dimensional dhe qëndrimet e partive për problemet specifike, 32

V. Shpërndarja e përgjigjeve, 47

VI. Kategorizimi i partive, 49
*PDK, 52*
*LDK, 55*
*AAK, 58*
*VV, 61*
*Të gjitha partitë në një grafikon, 64*

Përfundime dhe rekomandime, 65

Lista e botimeve, 67

Referencat, 70

# Përmbledhje ekzekutive

Nuk është për tu befasuar që partitë e formuara gjatë përpjekjeve për çlirim kombëtar nuk kanë ndonjë ideologji të definuar qartë. Fatkeqësisht, periudha pasi Kosova u vu nën administrim ndërkombëtar – dhe pamundësia për të qeverisur veten, nuk i ka shtyrë elitat politike që të krijojnë qëndrime të qarta për çështjet më të rëndësishme politike. Tani kur kosovarët kanë filluar të qeverisin veten, elita e tyre politike duhet të kenë qëndrime të cilat po i vënë gjithnjë e më shumë politikanët përballë njëri tjetri, si ndërmjet ashtu edhe brenda radhëve të partive – duke krijuar kështu një stimul shumë të rëndësishme për transformimin aq të nevojshëm.

Identifikimi i ideologjive të partive është shumë i vështirë në një shoqëri të posa dalur nga lufta e cila ende është duke bërë përpjekje për të plotësuar nevojat bazike dhe për të konsoliduar sovranitetin e saj. Ky dokument fillimisht shqyrton studimet e mëhershme, dhe vazhdon me diskutimin e qasjes dhe metodologjisë. Më pastaj dokumenti trajton disa modele të spektrit ideologjik dhe përfundon me modelin e përshtatshëm për qëllimin e këtij dokumenti. Studimi ka hulumtuar qëndrimet e profileve kryesore ideologjike në kontekstin e disa prej demokracive perëndimore. Është përpiluar një pyetësor i përshtatur për ketë qëllim i cili është përdorur për të intervistuar 160 zyrtarë të lartë të katër partive kryesore. Secilës përgjigje i është caktuar një vlerësim numerik dhe rezultatet pastaj janë paraqitur në mënyre grafike. Ne kemi identifikuar shpërndarjen e besimeve individuale brenda secilës parti dhe kemi marrë shpërndarjen e tyre kolektive si tregues real i asaj se ku qëndron partia.

Konsekuenca e qëndrimeve të shfaqura nga partitë politike është thelbësore gjatë tranzicionit derisa partitë gradualisht transformohen nga të qenit promotor të revolucionit, siç

ishin në kohën kur u themeluan, në mbrojtje të interesave klienteliste gjatë tranzicionit. Gjatë konsolidimit të demokracisë, disa parti transformohen, disa shuhen, shfaqen parti të reja– deri sa secila prej tyre arrin të përfaqësojë një elektorat stabil më të gjerë, të cilin nuk e lidh aspekti gjeografik por brengat dhe shqetësimet e njëjta.

Deri tani, në ato pak raste kur partitë kanë shfaqur tipare ideologjike, ato nuk kanë qenë asgjë më shumë sesa emërtime. Aspiratat e tyre gjithnjë e më shumë pasqyrojnë preferencat për t'iu bashkuar ndonjë grupi të partive pan-evropiane, e pak kanë të bëjnë me bindjet e anëtarëve të tyre. Për të shmangur kurthin e klasifikimit të një partie në një kuadrant të vetëm ideologjik, ne kemi zgjedhur të identifikojmë shpërndarjen e cila ilustron krahasimin ndërmjet dhe brenda partive.

Studimi tregon se rreth dy të tretat e zyrtarëve të partive janë të majtë ose konservativë. Në të vërtetë pothuaj nuk ekziston asnjë konservativ sa i përket vlerave dhe i djathtë sa i përket parimeve ekonomike. Shumica e një të tretës së mbetur, të cilët janë më të hapur sa i përket vlerave të tyre personale, po ashtu besojnë në ekonominë e tregut të lirë. Përshkrimi më lartë vlen për PDK, LDK dhe AAK përderisa Vetëvendosje është e majtë sa i përket ekonomisë, konservative në çështjen e identitetit, dhe liberale për liritë personale. Kjo tregon qartë se politikat konkrete publike nuk janë përcaktuese për orientimin e partisë, dhe se partitë përbrenda janë po aq të larmishme sa janë edhe kur krahasohen me të tjerat.

Krijimi i profilit të partisë lidhet ngushtë me një proces tjetër, atë të zhvillimit të grupeve të interesit. Grupet e shpërndara gjeografikisht duhet të lobojnë tek aktivistët e partive për të realizuar qëllimet e tyre. Meqë ata i zgjedhin përfaqësuesit e tyre në Kuvend të cilët i shprehin prioritetet e tyre, po ashtu mund të pritet që politika në Kuvend, në zyrat e partive politike dhe në prapaskena të fillojë të përfaqësojë grupet kryesore të votuesve.

Gjetjet e paraqitura në ketë raport ndihmojnë që të kuptohet më mirë shkalla e afërsisë së opinioneve dhe mund të inkurajojnë partitë të miratojnë qëndrime politike dhe të ndikojnë drejt një 'rirreshtimi' potencial. Ky dokument po ashtu tregon se transformimi i duhur nuk është i vogël.. Gjatë punës sonë në terren, një numër i madh zyrtarësh të partive e kërkuan një kopje të pyetësorit. Shpresojmë që ky dokument, me dyzet pyetjet e tij do të ndihmojë për të çuar përpara ketë proces evolutiv të konsolidimit të partive politike të Kosovës.

# I. Hyrje

Disa studime të mëhershme kanë bërë përpjekje të kodifikojnë profilet ideologjike të partive politike në Kosovë, por është vërejtur se kategorizimi i tyre në një kategori të caktuar ishte pothuajse e pamundur. Të gjitha studimet e mëhershme i kanë profilizuar partitë politike ashtu siç kishte deklaruar kreu i subjektit. Kjo nuk zhvleftëson profilizimin e diktuar nga lartë sepse partitë tona janë organizata që i nënshtrohen një hierarkie ku vendimet merren nga një grup i vogël i zyrtarëve. Edhe vendet të cilat kanë traditë të gjatë në demokraci e kanë të vështirë që t'i kategorizojnë partitë politike në njërën apo ideologjinë tjetër, e të mos flasim për një shoqëri e dalë nga lufta që akoma është duke bërë përpjekje të konsolidonë shtetësinë e vet.

Në këtë studim e pamë të udhës që t'i plotësojmë studimet e mëparshme, duke bërë një matje të mendimeve të individëve me ndikim brenda secilës parti. Shpërndarja kolektive e mendimeve paraqet një tregues më real se ku qëndron një parti politike, dhe çfarë trendi të votimit mund të pritet të kenë përfaqësuesit e tyre në legjislaturë.

Kjo mungesë e identitetit ideologjik mund të shpjegohet vetëm duke e pasur parasysh faktin se partitë politike në Kosovë u themeluan gjatë përpjekjeve për çlirim. Partitë u formuan prej grupeve të cilat ishin mobilizuar gjatë luftës ose rezistencës, dhe të cilat i bashkonte gjeografia, profesioni ose lidhja familjare. Andaj, vijmë deri te konkludimi se partitë mbledhin rreth vetes një pjesë të barabartë të individëve me prirje majtiste, liberale, ose nacionaliste, sepse këto anime nuk ishin fare kriter për përafrimin e tyre fillestar. Shumica e partive u themeluan para se vendi ta kishte një regjim demokratik e gjithashtu para se të fillojnë të paraqiten grupe të dallueshme socio-ekonomike, të cilat bashkohen për të mbrojtur një interes mirë të definuar në kutitë e votimit apo në legjislaturë.

Zhvillim evolutiv drejt profilizimit të partive politike u vonua edhe më shumë për shkak se kosovarët nuk e qeverisën vendin në pjesën më të madhe të periudhës së pasluftës. Për një kohë të gjatë Kosova u administrua nga bashkësia ndërkombëtare, gjë që privoi elitën politike nga qeverisja e vendit – dhe kjo mospjesëmarrje në qeverisje i kurseu politikanët e zgjedhur vendorë nga nevoja për tu pozicionuar për çështje specifike politike. Meqë Kosova nuk është anëtare e OKB-së, politika e saj e jashtme po ashtu mund t'ia lejoj vetes që të mos marrë ndonjë qëndrim për çështjet me rëndësi ndërkombëtare.

Hipoteza jonë fillestare ishte se mesatarja e koordinatave ideologjike brenda secilës parti nuk dallon shumë nga një parti në tjetrën. Partitë janë pragmatike prandaj shpërndarja e individëve luhatet nëpër spektrin ideologjik – prandaj nuk ka mbështetje për ndonjë pozicion për çështje të veçantë politik. Në raste kur partitë politike proklamojnë një emërtim apo cilësim ideologjik, ato më shumë e pasqyrojnë dëshirën e krerëve të tyre më të lartë se si dëshirojnë që të shihet partia e tyre nga jashtë.

Mungesa e koherencës nuk do të thotë se partitë lëvizin nga njëra anë e spektrit në tjetrën, por do të thotë se partitë politike nuk kanë pozicion koherent. Tani kur Kosova ka filluar të qeverisë veten, vendimmarrësit duhet të marrin vendime për çështje të vështira, gjë që i detyron ata që të jenë më të qartë sa i përket pozicioneve të tyre për çështje të caktuara. Sa më shumë çështje me të cilat ballafaqohet vendi, aq më e lehtë bëhet që të vërehet nëse vendimet janë koherente me kalimin e kohës.

Nëse qëndron supozimi se ka dallime brenda-partiake, qëndrimet e qarta domosdo nxjerrin në shesh dallimet e brendshme dhe inkurajon kalimet përtej vijave partiake. Një seri e tillë e transfereve parimore mund të inkurajojë transformimin aq të nevojshëm të skenës politike, ku miqësia më nuk shërben si ngjitës për të mbajtur partitë politike së

bashku por kjo zëvendësohet me konsistencën politike. Sa më shumë parti dhe individë që e shprehin mendimin e tyre, që votojnë në kuvend, që deklarohen haptazi për çështje të ndryshme, eventualisht largohen nga një parti për t'iu bashkuar tjetrës, sa më shumë parti të reja që formohen, votues të rinj që vendosin vet se cilës parti t'i bashkohen, aq më shumë mund të themi se ka ndodhur njëfarë shkalle e transformimit. Përkundër vështirësive që kjo sjell,

Ky evoluim pjesërisht është penguar nga perceptimi se integrimi në BE është proces teknik. Shumë ligje janë miratuar pothuaj në mënyrë mekanike meqë 'nuk ka nevojë për debat pasi që edhe vendet e përparuara evropiane tashmë e kanë marrë vendimin e njëjtë'. Impulsi politik për të dëshmuar progres të shpejt drejt BE-së bën që të merren vendime të shpejta, duke krijuar përshtypjen se debati publik është i tepërt. Sidoqoftë, janë një varg problemesh (privatizimi, çështja e shamisë, etj.) që kanë filluar t'i dallojnë partitë politike nga njëra-tjetra, e madje edhe të nxisin ndarje të mëdha brenda tyre.

Ky punim fillon me një analizë të studimeve të mëparshme, e cila pasohet me një diskutim për qasjen dhe metodologjinë e përdorur. Pastaj përshkruhen njëmbëdhjetë profilet kryesore ideologjike, të cilat shërbejnë si kontekst krahasues për të gjeturat e anketës sonë. Pjesa në vijim e bën një përshkrim të shkurtër të partive kryesore politike në Kosovë. Më tutje, punimi trajton disa modele se si portretizohet ideologjia në një spektër dy-dimensional, duke përfunduar me një model për të cilin kemi menduar se i përshtatet më së miri qëllimeve tona – fjala është për Diagramin Alternativ të Nolan-it. Pas kësaj i paraqesim të gjeturat e hulumtimit, duke i vendosur pikët e secilit pjesëmarrës në anketë në një diagram, për secilën parti veç e veç, si dhe në formë një-dimensionale, duke i përmbledhur të gjitha pikët e një partie për secilën pyetje veç e veç. Në fund interpretojmë rezultatet me një përmbledhje të shkaqeve që kanë kontribuar në një diagnozë

të këtillë.

## *Supozimet*

Shumica e partive politike në Kosovë u themeluan si pjesë e përpjekjeve për çlirim kombëtar. Për fat të keq, shumicës së tyre akoma iu konvenon ta ruajnë kulturën e tyre të mbyllur. Me t'u përmbushur objektivi i pavarësisë, dëshirat për pasurim personal i shndërruan partitë thjeshtë në mjet për të fituar pushtet, krejtësisht të zhveshura nga parimet. Partitë kanë krijuar dhe ruajtur patronazhe dhe rrjete klienteliste deri në atë masë saqë kjo shpesh është qëllimi i vetëm e fushatave zgjedhore.

Tradita e shkurtër e demokracisë në Kosovë ka arritur të prodhojë një nivel të procedurave demokratike, por nuk ka arritur t'i thellojë ato si vlera. Shumica në parlament kërkon të ketë numra të mjaftueshëm për ta mundur opozitën, dhe se partitë kryesore asnjëherë nuk përpiqen të arrijnë konsensuse pavarësisht se sa është e rëndësishme çështja në rend të ditës. Polarizimi, bllokimi dhe krizat politike janë bërë gjithnjë e më të shpeshta, dhe shumica parlamentare shpesh mbështetet tek partitë shumë të vogla për të siguruar numrat.

Ka disa arsye pse një individ i bashkohen një partie, (a) simpatia për udhëheqësin, (b) afërsia gjeografike, (c) interesi personal, (b) lojaliteti nga koha e luftës, (e) gjasat që një parti t'i fitojë zgjedhjet ose (f) njoftësia personale e votuesit me partinë, dhe rrjedhimisht edhe gjasat për përfitime personale. Si rrjedhojë, mendimi i njëjtë për preferencat mbi politikat publike renditet shumë poshtë në listën e prioriteteve. Duke i lënë anash platformat politike, gjasat për përfitime personale janë shumë më të rëndësishme sesa politikat formale apo platformat zyrtare. Në të njëjtën kohë, preferencat e votuesve për çështjet madhore nuk u komunikohen si duhet partive politike, gjë që nuk i shtyn partitë që të krijojnë platformave të qarta.

Duke e pasur parasysh evoluimin gradual të partive politike në Kosovë dhe kalimet e shumta nga një parti në tjetrën, kjo periudhë përbën një fazë ideale për analizë më të hollësishme të çështjeve dhe për të krijuar një pasqyrë më të saktë të opinionit të personave më me ndikim. Me një punim tjetër, D4D është duke kontribuar vazhdimisht për t'i lidhur agjendat e grupeve që bazohen në anëtarësi, si grupe të reja të interesit, me partitë politike dhe me politikanë individualë.

Deri vonë politikanët në masë të madhe janë bazuar në marrjen e votave nga një zonë e caktuar gjeografike, duke pasqyruar një lojalitet ndaj strukturave që bazohen në miqësi dhe lidhje familjare. Megjithatë, është me rëndësi të identifikohen veçoritë e kulturës politike që do të mund të nxisnin votuesit të identifikojnë politikanët që ndajnë mendim të njëjtë me ta pavarësisht prejardhjes së tyre gjeografike.

Rruga e zhvillimit të partive të Kosovës për krijimin e konsistencës në qëndrimet e veta lidhet ngushtë me rrugën e politikës së Kosovës drejt modernizimit. Me përmbushjen e nevojave themelore (për rrugë, ujë, kanalizim), premtimet që kosovarët e zonave rurale presin të përmbushen janë më pak të lidhura me kufijtë gjeografik. Të menduarit e njëjtë që i lidh kosovarët e rinj kanë të bëjnë me profesionin, gjininë, hobin, përkatësinë etnike ose grup-moshën. Kjo ia hap rrugën secilit deputet që të synojë votuesit e profileve specifike në tërë Kosovën, e cila mundësohet nga fakti se Kosova është një zonë e vetme zgjedhore.

Së fundmi, duket se një numër gjithnjë e më i madh i zyrtarëve të zgjedhur po e kuptojnë nevojën që t'i ri-formulojnë prioritetet e tyre kryesore dhe t'i ruajnë votuesit e vet në bazë të zgjidhjeve politike që i bëjnë. Partitë me objektiva të mirëfillta (qoftë me konsistencë ideologjike ose jo) do t'i përkrahnin interesat e grupeve të caktuara për dallim nga politikat sporadike që me siguri i shtyjnë përpara interesat e udhëheqësve të partive dhe rrjeteve të tyre

klanore. Partitë mund të rriten dhe të fitojnë votues të rinj nëse ua bëjnë më të lehtë votuesve që t'i mbajnë përgjegjës përfaqësuesit e tyre për performancën në zbatimin e këtyre politikave.

Vetëm kur diskutimi politik bëhet më i fokusuar në çështje të caktuara, deputetët e Kuvendit mund të bëhen cak i lobimit të grupeve me anëtarësi. Rezultat i kësaj do të jetë një deputet që i jep më shumë llogari votuesve sesa krerëve të partive politike, e kjo shpie në mbrojtjen më të madhe të interesave ë qytetarëve. Si rrjedhojë, Kuvendi shndërrohet në një arenë të vërtetë ku përplasen interesat e ndryshme të cilat bëjnë garë për vëmendje politike, buxhet dhe legjislacion të favorshëm. Një komunikim më dinamik mes shoqatave të organizuara mirë dhe deputetëve me pozitë specifike mund ta përmirësojë cilësinë dhe pjesëmarrjen në zhvillimin e politikave. Si rrjedhojë, partitë politike do të jenë më të përgjegjshme për çështjet e ndryshme dhe ndaj grupeve të caktuara të votuesve, e më pak individualist dhe klientelist.

## *Qëllimi*

Përveç vlerës së tij akademike, ky identifikim dhe kategorizim ka për qëllim tu ndihmojë partive politike duke vlerësuar shkallën e koherencës për temat kryesore të politikave publike në mesin e zyrtarëve të lartë. Një numër i vogël individësh vendos se cili është profili më i mirë për partinë. "Emërtimi" vjen vetëm 'nga lartë' dhe udhëhiqet nga dy kritere: (a) perceptimit naiv që 'e djathta' nënkupton perëndimore, dhe (b) shtytjes për t'iu bashkuar grupit parlamentar pan-evropian që partia vendos t'i bashkohet.

Shumica e partive ende nuk kanë lëvizur prej deklaratave normative, të cilat e tregojnë dëshirën e lidershipit se në çfarë drejtimi synon të zhvillojë partinë në të ardhmen. Profilin të cilin e kërkojnë nuk përkon me qëndrimin që e kanë për çështje të ndryshme e as me historinë e votimit të tyre në Kuvend. Më keq akoma, udhëheqja e lartë e partisë nuk

lodhet që ta shndërrojë emërtimin ideologjik në udhëzim konkret si duhet të votojnë dhe të pozicionohen zyrtarët e niveleve më të ulëta dhe simpatizantët e saj.

Se a do ta arrijë partia në destinacionin e përcaktuar nga organet e saj udhëheqëse, varet prej mendimeve të një grupi më të gjerë të udhëheqësve. Për këtë, është me rëndësi thelbësore të analizohen mendimet e një rrethi më të gjerë të zyrtarëve dhe aktivistëve me ndikim në parti. Konsistenca e qëndrimeve të partive politike është me rëndësi themelore në transicion, pasi partitë transformohen gradualisht nga të qenit mjete për realizimin e interesave të grupeve të caktuara në të qenit përfaqësues të një baze stabile të votuesve me interesa të përbashkëta specifike.

Një profil i qëndrueshëm do të kontribuonte edhe në disiplinimin e vet partisë. Aktualisht, popullariteti buron prej emrave të caktuar, dhe sa herë që një zyrtar i lartë kalon në një parti tjetër, ai/ajo i merr me vete edhe simpatizantët e vet. Po që se popullariteti do të buronte nga politikat që i ndjekë partia, dhe ku individët do të ishin vetëm një personifikim i një identiteti më afatgjatë politik, atëherë partitë do të ishin më imune ndaj dëmeve që shkaktohen prej kalimeve të këtilla. Një individ i cili i mbron, të themi, politikat i lirisë individuale vështirë se mund t'i bashkohet një partie e cila nuk i përshtatet qëndrimeve të tij/saj. Përderisa ideologjia do ta forconte disiplinën e partisë, konsistenca e mendimeve mund ta kufizojë lirinë e veprimit të udhëheqësve individualë dhe do ta forconte demokracinë e brendshme partiake.

## *Analizë e literaturës*

Katër studimet e analizuara më poshtë kanë ofruar një pikënisje të shkëlqyeshme ku do të mund të bazohet D4D, dhe ta çojë debatin përpara. Secili prej studimeve të analizuara është përpjekur të gjejë konsistencën brenda partive vetëm për të ardhur në përfundim se nuk ka një konsistencë të tillë. Ato janë përpjekur t'i kategorizojnë

partitë aktuale në një profil të veçantë, porse kanë ardhur në përfundim se partitë luhaten prej një pozicioni në tjetrin.

Zulfaj, Jeton and Mulliqi, Brikena. 15 Apr 2008. Political Parties in Kosova: Profile and Ideology. Friedrich Ebert Stiftung. http://www.fes-prishtina.org/pdf/final_draft_en.pdf

"*Partitë Politike në Kosovë: Profili dhe Ideologjia*" është një raport i përpiluar prej organizatës Friedrich Ebert Stiftung (FES) në vitin 2009, dhe trajton mungesën e përcaktimit të qartë të ideologjive politike te partitë që ekzistojnë në Kosovë. Në përpjekje për identifikimin e preferencave ideologjike, ky raport harton një profil për gjashtë parti politike, i cili u përcaktua në bazë të përgjigjeve të marra në intervistat e detajuara. Pesë nga gjashtë partitë politike të profilizuara emërtohen si "të qendrës së djathtë", me përjashtim të Partisë Reformiste (ORA) të emërtuar si "e qendrës së majtë". Megjithatë, autorët e raportit vërejnë se "partitë politike kanë për qëllim maksimizimin e votave, prandaj edhe lëvizin në spektrin politik herë në të djathtë e herë në të majtë".[1] Raporti i FES-it i sfidon partitë politike që t'i identifikojnë më mirë ideologjitë e tyre dhe të krijojnë programe që përkojnë me profilin e tyre.

Gündogan, Ercan. August 2009. Some Observations on the Empirical Research for the Political and Ideological Orientation of the Youth Between 18 and 24 Ages in Kosovo. ISES Universum. http://www.universum-ks.org/repository/docs/Observations%20on%20Kosovo%20Youth.pdf

Ky raport e paraqet mendimin e të rinjve në Kosovë sipas matjes së bërë përmes pyetësorëve për matjen e preferencave politike dhe ideologjike. Janë bërë pyetje të përgjithshme, p.sh. "A vjen në rend të parë shteti apo qytetari?" Pyetësori kishte edhe pyetje që kërkonin përcaktimin e mendimit politik? ku përgjigjet e mundshme ishin liberal, konservator,

religjioz, nacionalist, fashist, republikan, socialist, komunist, anarkist, dhe të tjerë. Për fat të keq, pyetjet në ketë studim shpesh ishin të paqarta dhe nuk ka ndonjë analizë të lidhjeve në mes të përgjigjeve lidhur me ideologjitë politike dhe përgjigjeve lidhur preferencat partiake. Në vend të kësaj, analiza është paraqitur me dy përfundime të veçanta: qëndrimi ideologjik i të rinjve (socio demokratik, laik, dhe republikan) dhe rreshtimi partiak i të rinjve (i polarizuar në mes të PDK-së dhe LDK-së).[2]

Hofmeister, Wilhelm and Grabow, Karston. April 2013. Political Parties: Functions and Organisation in Democratic Societies. Konrad Adenauer Stiftung. http://www.kas.de/wf/doc/kas_34067-1522-1-30.pdf?130417190943

"*Partitë Politike: Funksionet dhe Organizimi në Shoqëritë Demokratike*" është raport i botuar nga Fondacioni Konrad Adenauer në Prishtinë në vitin 2013. Ai ofron një analizë të thellë të strukturave, klasifikimit dhe qëllimit të partive politike ekzistuese anembanë botës. Sa i përket Kosovës, nxirret si përfundim në këtë raport se "partia dhe ideologjia nuk bashkekzistojnë". "Partitë politike në Kosovë janë zhvilluar pa debat për ideologjinë ... të gjitha partitë politike të Kosovës u transformuan vazhdimisht sa në njërën anë sa në tjetrën, sa në të majtë e sa në të djathtë".[3]

Shaipi, Kushtrim and Maliqi, Agon. May 2008-2009. Party Analysis Reports. Friedrich Ebert Stiftung.

Seria e *raporteve të analizave të partive* të Shaipit ka sjellë qasjen e studimit të çështjeve një nga një në realizimin e hulumtimit të ideologjive në Kosovë. Shaipi e bën një analizë metodologjike të të dhënave të dorës së dytë (media, deklarata të misionit, etj.) me intervista në nivelin e çështjeve të caktuara. Arsyeja e kësaj metodologjie qëndron në atë se partitë politike nuk përgatisin përgjigje për çështje specifike, por pyetje për profilizimin e përgjithshëm ideologjik. Raporti

i parë u fokusua në pensione, kujdes shëndetësor dhe privatizim, i dyti në vlera, fe, shtet, dhe individualitet, dhe i treti në privatizim, politika fiskale dhe zhvillim.

## Metodologjia

Metodologjia fillestare u zhvillua për klasifikimin e përcaktimit ideologjik, përmes zhvillimit të anketave për mbledhjen e opinioneve të dyzetë zyrtarëve të lartë të secilës prej katër partive kryesore. Pyetësori nuk parashtroi pyetje të hapur për prirjet ideologjike, por i parashtroi dyzet pyetje specifike për një varg çështjesh. Secila përgjigje përkon me një sistem të pikëve, e cila pastaj paraqitet në një diagram.

Për t'u siguruar që pyetësori të mund të shërbejë si mjet i besueshëm për këtë detyrë, D4D së pari identifikoi ideologjitë kryesore politike anembanë botës, si dhe bëri një hulumtim të thellë të mendimeve të cilat i përfaqësojnë. Janë analizuar me kujdes të veçantë pikëpamjet tipike për një gamë të gjerë çështjesh (si tatimi, aborti, mirëqenia, etj.) në kontekste të ndryshme të demokracive perëndimore, si një krahasim i dobishëm për ta zhvilluar një instrument specifik studimi për Kosovën.

Secila ideologji u rendit në një shkallë sipas qëndrimit ideologjik për një çështje të caktuar. Këto tema dhe pyetje të përgjithshme janë kombinuar me hulumtimin e çështjeve që lidhen me Kosovën, dhe kjo është përdor si bazë për krijimin e një pyetësori specifik për Kosovën.

Për secilën pyetje, janë paraqitur disa opsione si përgjigje. Më pas, pyetjet (si dhe përgjigjet) janë modifikuar për t'ju përshtatur kontekstit të Kosovës. Secilës përgjigje të mundshme i është caktuar një vlerë numerike, nga -10 (shumë majtist ose konservator) deri në +10 (i djathtë ose liberal).

Anketa prej dyzet pyetjeve dhe një vargu të madh përgjigjesh të mundshme për secilën pyetje na shërbeu si udhëzues për

t'i vendosur aktivistët e partive kosovare në spektrin ideologjik. Më pas D4D realizoi intervista me 40 zyrtarë të lartë nga secila prej katër partive kryesore, gjithsej 160. Përgjigjet u mblodhën dhe u vendosën në diagram, duke u bazuar në vlerën mesatare numerike të rezultateve të tyre. Shuma e përgjigjeve të secilit pjesëmarrës në anketë u përmblodh në një rezultat të përgjithshëm, i cili po ashtu u paraqit në diagram. Ky prezantim na ndihmoi që ta përkufizojmë ideologjinë e tyre politike për secilën çështje, për secilin pjesëmarrës të anketës, dhe për secilën parti si tërësi.

Pyetësori u testua dhe u diskutua me mbi 30 analistë me përvojë, siç u testua edhe pesha e secilës pyetje. Meqenëse jo të gjitha pyetjet kanë rëndësi të njëjtë, pesha e tyre u diskutua gjerë e gjatë me disa analistë politikë, me komentues, aktivistë të partive; dhe pesha e pyetjeve që paraqitet më poshtë e pasqyron mesataren e asaj se çfarë mendonin shumica se është e përshtatshme. Përgjigjet për secilën pyetje kontribuuan për matjen e koordinatave të secilit pjesëmarrës përgjatë secilit prej dy boshteve, atij ekonomik (boshti horizontal) dhe politiko/social (boshti vertikal). Më poshtë është paraqitur një përmbledhje e çështjeve të vlerësuara, si dhe pesha që secila ka kundrejt pikëve të përgjithshme dhe për të dy dimensionet.

| | **Pyetjet** | **Ekonomia** | **Vlerat** |
|---|---|---|---|
| 1 | Rregullimi i tregtisë | 8 | 0 |
| 2 | Taksat doganore | 7.5 | 0 |
| 3 | Private *vs*. publike | 6 | 4 |
| 4 | Subvencionet | 6 | 2.5 |
| 5 | Subvencionet në bujqësi | 4 | 2 |
| 6 | Tatimi mbi vlerën e shtuar | 7 | 0 |
| 7 | Tatimi i sheshtë apo progresiv | 4.5 | 4.5 |
| 8 | Investimet dhe ndihmat e huaja | 6 | 2.5 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 9 | Sindikatat e punëtorëve | 4 | 4 |
| 10 | Paga minimale | 4 | 4 |
| 11 | Pushimi i lehonisë | 4 | 4 |
| 12 | Ditët e pushimit dhe festat kombëtare | 5 | 2 |
| 13 | Roli i bashkësisë ndërkombëtare | 0 | 5 |
| 14 | Madhësia e administratës publike | 4 | 3.5 |
| 15 | Niveli i shpenzimeve publike | 4 | 3.5 |
| 16 | Ligjshmëria dhe kostoja e abortit | 1 | 4.5 |
| 17 | LGBT | 0 | 6 |
| 18 | Shoqëria civile | 0 | 6 |
| 19 | Multi-etniciteti | 0.5 | 4 |
| 20 | Trajtimi i veçantë i pakicave | 0 | 5 |
| 21 | Marrëdhëniet ndëretnike | 0.5 | 5 |
| 22 | Integrimi evropian | 3.5 | 5 |
| 23 | Imigrimi | 2 | 4 |
| 24 | Mjedisi | 5.5 | 3 |
| 25 | Mësimi për fenë | 1 | 4 |
| 26 | Globalizimi | 5 | 3 |
| 27 | Ndihma sociale | 5 | 2.5 |
| 28 | Sistemi shëndetësor i privatizuar *vs* publik | 4 | 2 |
| 29 | Shpenzimet publike për kujdesin shëndetësor | 3.5 | 2 |
| 30 | Pensionet | 4 | 6 |
| 31 | Feja *vs*. shteti | 2 | 5 |
| 32 | Drogat | 3.5 | 4 |
| 33 | Bixhozi dhe bastoret | 3 | 4 |
| 34 | Prostitucioni | 3.5 | 5 |
| 35 | Interesi individual *vs*. kolektiv | 3 | 6 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 36 | Kultura dhe tradita | 1.5 | 5 |
| 37 | Vlerat e familjes | 0 | 5.5 |
| 38 | Privatizimi | 5 | 5 |
| 39 | Akciza | 3.5 | 2 |
| 40 | Hapja e vendeve të punës | 5.5 | 3 |

Sa herë që një pjesëmarrës në anketë nuk mundi të zgjedhë njërin prej opsioneve të përgjigjeve, anketuesi kërkonte përgjigje të detajuar cilësore, për të cilën më vonë ekipi diskutonte se sa pikë t'ia caktonte.

## II. Përshkrimi i profileve kryesore ideologjike

Për të zhvilluar një instrument sa më të saktë, ne kemi bërë hulumtime të hollësishme lidhur me qëndrimet e përqafuara nga grupimet e ndryshme ideologjike të demokracive liberale perëndimore. Në vijim e kemi dhënë një përshkrim të shkurtër të profileve kryesore ideologjike për t'ia bërë më të lehtë lexuesve që mund të mos i dinë dallimet e vogla mes profileve të ndryshme. Ne kemi dhënë përshkrime të shkurtra të ideologjive në vijim: *socialiste, majtiste, e qendrës së majtë, e qendrës së djathtë, djathtiste, social demokrate, liberale, autoritare, nacionaliste, lirive individuale,* dhe *konservative*. Varësisht prej njohurive të lexuesit ky seksion mund të shërbejë si orientim kyç (për lexuesin me më pak njohuri), për qëllime krahasuese (për lexuesin me njohuri më të thella), ose thjeshtë si freskim i informacionit për këto çështje.

### *Socialistët*

Socializmi është teori politike dhe ekonomike e cila beson se prodhimi, shpërndarja dhe këmbimi duhet të jenë pronë publike ose të rregullohet nga bashkësia si tërësi.[4] Me këtë sfidohet struktura sociale e krijuar përmes kapitalizmit, në të cilën klasat më të larta ushtrojnë kontroll më të madh mbi industrinë sesa klasat më të ulëta. Për ta siguruar suksesin e këtij sistemi kolektiv të jetesës, socialistët e inkurajojnë intervenimin dhe rregullimin e fuqishëm nga ana e qeverisë, pasi ajo e ka për detyrë ta mbikëqyrë shpërndarjen e barabartë të mallrave dhe shërbimeve në tërë shoqërinë. Si rrjedhojë, socialistët e përkrahin idenë se shteti është pronari kryesor pasi është në pozitën më të mirë të ofrojë shërbime në mënyrë të barabartë për të gjithë qytetarët.[5]

Në kohët moderne, socialistët evropianë në përgjithësi i favorizojnë politikat që promovohen nga demokracia sociale

sesa ato të anarkizmit ose komunizmit, edhe pse termi "socializëm" i përfshinë një varg të gjerë ideologjish politike.[6] Faktori i përbashkët i të gjitha ideologjive socialiste është pikëpamja sa i përket rolit të shtetit në sistemin ekonomik. Socialistët priren që ta vënë në rend të parë edhe mirëqenien publike dhe drejtësinë sociale, duke u identifikuar më shumë me politikën majtiste sesa me atë djathtiste.[7]

Disa shembuj të partive moderne socialiste janë: Partia e Socialistëve Evropianë (PES), Aleanca Progresive e Socialistëve dhe Demokratëve (S&D)[8], Partia e Majtë Socialiste e Norvegjisë (SV), dhe Partia e Punëtorëve Socialistë të Spanjës (PSOE).[9]

## *Të majtit*

Politika majtiste, ose "ideologjia e krahut të majtë", renditet në spektrin ideologjik të majtë/djathtë. Ajo përfaqëson disa pikëpamje politike, të cilat i japin mbështetje barazisë sociale kundrejt hierarkisë sociale,[10] dhe e vlerëson lirinë personale mbi lirinë ekonomike.[11] Majtistët e përkrahin barazinë para ligjit, si dhe priren t'i japin prioritet tolerancës për fetë dhe racat e ndryshme, politikës së huaj diplomatike, dhe globalizimit.

Partitë politike të krahut të majtë klasifikohen edhe më tej në nën-kategori si "liberal", "demokrat" dhe "komunist". Sa i përket lirive personale, partitë e krahut të majtë e përkrahin idenë për drejtësi më të madhe sociale, shpesh e realizuar përmes zbatimit të të drejtave për grupet e pakicave, si për gratë, homoseksualët, dhe pakicat etnike. Majtistët qëndrojnë në pozicion të kundërt me partitë politike të krahut të djathtë, të cilat i japin më shumë prioritet vlerave tradicionale dhe më pak intervenimeve qeveritare.[12] Sa i përket ekonomisë, majtistët i kundërshtojnë forcat e tregut. Në vend të kësaj, ata e përkrahin pronësinë publike, ekonominë e kontrolluar dhe mbështetjen për klasën punëtore. Shembuj të partive politike të krahut të majtë janë

partitë komuniste, partitë e punës, social demokratët, partitë e reja të majta, dhe partitë e gjelbra.[13]

Partitë politike të qendrës së majtë janë nënkategori e ideologjisë majtiste. Gjithashtu sa i përket atyre që u referohemi si të majta të moderuara, ato kanë një qëndrim pak më konservativ për çështjet sociale dhe ato ekonomike sesa pikëpamjet e krahut të majtë ekstremist. Në spektrin politik, qendra e majtë i favorizon ndryshimet progresive kundrejt vazhdimësisë së traditës; megjithatë, ato brengosen më pak për ndryshimet në krahasim me ato që janë shumë të majta.[14] Janë më të hapura ndaj ekonomisë së tregut. Shembuj të partive të qendrës së majtë përfshijnë partitë social demokrate, partitë e gjelbra, dhe Partinë Demokratike të Italisë (PD).[15]

## *Socialdemokratët*

Social demokracia është një ideologji politike dhe ekonomike që e përkrah tranzicionin gradual dhe paqësor prej kapitalizmit në socializëm, përmes proceseve të konsoliduara politike gjatë tërë procesit të transicionit.[16] Socialdemokratët i përkrahin ekonomitë e përziera të tregut (ngjashëm me pikëpamjet e partive të qendrës); ato nuk shohin ndonjë konflikt mes kapitalizmit dhe ekonomisë së tregut të lirë.[17]

Social demokratët e theksojnë rëndësinë e barazisë sociale në shoqëri, por e lejojnë edhe pronësinë private. E përkrahin shtetin e mirëqenies me vlera të lira tregut; shpesh kjo njihet edhe si "kapitalizmi i mirëqenies."[18] Sa i përket lirive personale, socialdemokratët janë të lidhur me sindikatat e punës dhe lëvizjet punëtore, dhe e përkrahin idenë e mbrojtjes kolektive të të drejtave të punëtorëve.[19] Shembuj të partive moderne socialdemokrate janë Partia e Punës e Australisë, Partia Social Demokrate e Gjermanisë (SDP), dhe Partia e Punës e Zelandës së Re.[20]

## Liberalët

Liberalizmi është një ideologji politike që u jep rëndësi të drejtave dhe lirive të individit, të cilat shpesh garantohen përmes institucioneve qeveritare.[21] Idetë liberale lidhen me progresivizmin: avancimin e ndryshimit në kuadër të një sistemi social që ka ekzistuar përpara. Kjo është në kundërshtim me konservatizmin, i cili e përkrah idenë e kthimit në vlerat sociale e tradicionale.

Teoritë liberale të drejtësisë sociale e promovojnë të kuptuarit modern të lirisë, si lirinë e shprehjes, lirinë e fesë, dhe lirinë për t'u organizuar. Në mënyrë që të mbrohen dhe të ruhet këto liri themelore, liberalët e lënë pushtetin në duar të sektorit publik, dhe ia mundësojnë qeverisë që t'i zbatojë ligjet për mbrojtjen e barazisë.[22]

Në aspektin ekonomik, liberalët e favorizojnë një sistem në të cilin kufizohet roli i qeverisë në ofrimin e përkrahjes dhe të shërbimeve.[23] Shumë parti liberale i përkrahin sistemet e mirëqenies, të kujdesit shëndetësor, si dhe programet për krijimin e vendeve të punës të financuara nga qeveria. Shembuj të partive liberale janë Partia Aleanca Demokratike e Shqipërisë, Forumi Liberal (LiF) në Austri,[24] Partia e Lirë Demokratike (FDP) e Gjermanisë[25], dhe Partia Liberale (V) e Norvegjisë.[26]

## Autoritarët

Një qeveri autoritare e përfaqëson atë lloj të sistemit politik, i cili e kundërshton lirinë e mendimit dhe veprimit individual, duke e favorizuar, në vend të kësaj, nënshtrimin ndaj autoritetit. Regjimet autoritare e koncentrojnë pushtetin në duart e një prijësi të vetëm (kreun e shtetit) apo në duart e një grupi të vogël të elitës politike. Udhëheqësit autoritarë e ushtrojnë pushtetin pa i kushtuar vëmendje strukturës ligjore, si dhe përpiqen ta kufizojnë rolin e partive politike kundërshtare.[27]

Në përgjithësi, regjimet autoritare identifikohen me të djathtën ekstreme politike; shpesh u referohemi si “diktatura të krahut të djathtë”. Autoritarizmi përgjatë historisë është arritur funksionalizohet në shkallë të ndryshme të suksesit; shembuj të regjimeve të kaluara autoritare janë qeveritë fashiste, si nazistët gjermanë dhe Spanja nën Frankon, si dhe monarkitë absolute si ajo e Luigjit XIV të Francës dhe Rusia nën Pjetrin e Madh.[28]

Studimet kanë treguar se rritja ekonomike ndodh si në qeveritë autoritare ashtu edhe në ato demokratike.[29] Megjithatë, për shkak se autoritarët përpiqen t’ çrrënjosin liritë personale, ekonomia nuk zhvillohet në mënyrë të njëjtë sa do të zhvillohej nën ekonominë e tregut të lirë. Në vend të kësaj, është qeveria e centralizuar ajo e cila i dikton të gjitha vendimet ekonomike. Sot, regjimet autoritare ekzistojnë në vende si Arabia Saudite dhe Siria.[30]

## *Nacionalistët*

Nacionalizmi beson në atë që secili komb duhet ta formojë shtetin e vet, dhe se qytetarët e tij duhet të identifikohen sipas përkatësisë kombëtare.[31] Struktura sociale që përkrahet nga kjo ideologji është ajo e *kombeve shtete*, apo e shteteve politike të përbëra nga qytetarë që kanë një trashëgimi të përbashkët kulturore.[32]

Lëvizjet nacionaliste burojnë prej partive politike ultra-konservatore, të cilat rreshtohen më shumë me partitë e djathta politike sesa me ato të majta. Dihet historikisht se lëvizjet nacionaliste kanë luajtur rol në formimin e shteteve si Gjermania dhe Italia, dhe se nacionalizmi i ka karakterizuar ideologjitë moderne me ndikim, fjala vjen si pan-arabizmi. Ngritja e partive moderne nacionaliste në ditët e sotme lidhet ngushtë me problemet e imigrimit modern dhe me procesin e “evropianizimit”, apo me integrimin në Bashkimin Evropian.[33]

Partitë nacionaliste e shfrytëzojnë frikën prej kulturave të huaja të cilat e cenojnë kulturën vendore, duke fituar kështu mbështetjen e votuesve ksenofobë. Përveç qëndrimit të tyre kundër imigrimit dhe pozicionit të tyre sa i përket integrimit evropian, nacionalistët nuk identifikohen me ndonjë politikë të veçantë apo të dalluar; megjithatë, priren që të votojnë krahas ideve konservatore.[34]

Në ditët e sotme mund të gjejmë qeveri nacionaliste kryesisht në Azi dhe në Lindje të Mesme, ndonëse edhe partitë nacionaliste evropiane ushtrojnë ndikim politik,[35] dhe se janë kthyer sërish në skenën politike në zgjedhjet evropiane në vitin 2014. Shembuj në Evropë janë Partia Nacionale Skoceze e Britanisë së Madhe, Partia Unioniste e Ulsterit, Partia Aleanca Nacionale e Italisë, dhe Fronti Nacional i Francës.[36]

## *Libertarianët*

Libertarianizmi është një teori moderne politike që kryesisht gjendet në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Themeli i kësaj ideologjie buron nga dhënia prioritet lirive individuale, qoftë ekonomike, personale, ose sociale.[37] Kjo rezulton në besimin se duhet të kufizohet, nëse jo të eliminohet, intervenimi i qeverisë në jetën e qytetarëve, me qëllim që të mbrohen liritë individuale nga shteti. Libertarianët nuk zënë vend drejtpërdrejt në spektrin politik të majtë/të djathtë, meqë i përqafojnë liritë majtiste personale si të drejtat e pakicave krahas lirive ekonomike të krahut të djathtë, si tregun e lirë dhe privatizimin e kujdesit shëndetësor. Politikat të cilat përkrahen nga libertarianët përfshijnë heqjen e pagës minimale, heqjen e mirëqenies, zvogëlimin drastik të tatimeve, politikën jointervenuese të jashtme, dhe legalizimin e martesave të homoseksualëve.[38]

Në Evropë ka pak grupime libertariane politike meqë libertarianizmi është një ideologji e re. Megjithatë, Partia Libertariane e SHBA-ve është partia e tretë më e madhe politike në Shtetet e Bashkuara.[39]

## Të djathtit

E djathta politike përfaqëson një varg pikëpamjesh politike që e vlerësojnë traditën në vend të ndryshimit progresiv, si dhe besojnë në lirinë ekonomike. E djathta beson se biznesi nuk duhet të rregullohet; por, e thekson rëndësinë e individualizmit dhe fuqinë e ekonomisë së tregut të lirë.[40] Mbështetësit e krahut të djathtë i promovojnë politikat e jashtme më agresive dhe priren të pozicionohen kundër imigracionit.

Në aspektin ekonomik, e djathta politike e favorizon rregullimin minimal të tregut, privatizimin e industrisë, dhe norma më të ulëta të tatimit. Sa i përket lirive personale, partitë e krahut të djathtë nuk i japin prioritet drejtësisë sociale, dhe janë kundër idesë që qeveria të zbatojë legjislacion kundër diskriminimit. E djathta qëndron në anën e kundërt të partive politike të krahut të majtë, të cilat i japin prioritet vlerave më progresive dhe intervenimeve më të mëdha të qeverisë.[41]

Sa i përket ekonomisë, partitë e krahut të djathtë besojnë në fuqinë e forcave të tregut. Për shkak se e përkrahin ekonominë e tregut lirë, e djathta i atribuohet më shumë klasave të mesme dhe të larta.[42] Shembuj të partive politike moderne të krahut të djathtë janë partitë nacionaliste, kristian demokratët, liberalët klasikë, dhe partitë konservatore.[43]

Qendra e djathtë politike është nënkategori e së djathtës. Meqë i referohemi edhe si e djathta e moderuar, pikëpamjet e saj zënë një pozitë më liberale për problemet sociale dhe ato ekonomike sesa pikëpamjet e krahut të djathtë ekstrem.

## Konservatorët

Konservatizmi është një teori politike dhe ekonomike, e cila i përkrahë vlerat tradicionale kundrejt ndryshimeve progresive sociale. Partitë konservatore i përkrahin liritë e

individit brenda ekonomisë; i mbështesin sistemet e tregut të lirë, të cilat e kufizojnë përkrahjen dhe rregullimin nga ana e qeverisë.[44] Megjithatë, partitë konservatore anojnë kah një pozicion më agresiv sa i përket mbrojtës kombëtare, politikave të jashtme dhe imigracionit.

Sa i përket lirive personale, konservatorët rreshtohen në krahun e djathtë; nuk e kanë prioritet drejtësinë sociale, dhe politikat e tyre më shumë shkojnë në të mirë të klasave të mesme dhe të mesme të larta sesa të klasave të ulëta, duke i shpërblyer ata që kanë arritur të kalojnë në klasat më të larta në shoqërinë kapitaliste.[45] Sa i përket çështjeve të caktuara progresive, si politikat e mjedisit, konservatorët kanë filluar ta mbështesin ndryshimin, megjithëse në një masë më të vogël se partitë liberale, dhe janë me dy mendje sa i përket çështjes së Integrimit Evropian.[46]

Sot, partitë konservatore shtrihen gjithandej si në Evropë ashtu edhe në Amerikën Veriore. Shembuj për këtë janë Forca Italia në Itali, Partia e Pavarur e Islandës, Fianna Fail e Irlandës. [47]

# III. Një pasqyrë e shkurtër e skenës partiake

Në këtë seksion përshkruhen partitë politike në Kosovë dhe rastet kur identifikohen me një profil të caktuar ideologjik. Ndryshe prej anketës, këtu përshkruhen rastet kur ato identifikojnë veten qartë me një pozicion ideologjik, që zakonisht gjenden në deklaratat e udhëheqjes partiake, në programin e partisë, ose nënkuptohet përmes përpjekjeve të tyre për anëtarësim në grupimet partiake pan-evropiane.

## *PDK*

Partia Demokratike e Kosovës (PDK) u themelua më 14 maj 1999. Ajo u krijua prej krahut politik të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, dhe udhëhiqet prej Hashim Thaçit, një ish pjesëtar i UÇK-së[48]

PDK-ja kryesisht përkufizohet si parti e qendrës së djathtë në spektrin politik, dhe ka një kombinim të politikave liberale në aspektin ekonomik, por edhe atyre konservatore në aspektin social; për shembull, përkrahja e tregut të lirë dhe tatimeve të ulëta, si dhe ruajtja e vlerave tradicionale.[49] Një shembull i mirë është përkushtimi i vendosur i PDK-së së fundmi për privatizimin e Postës dhe Telekomunikacionit të Kosovës (PTK) përkundër disa zërave kundërshtues brenda dhe jashtë partisë.

PDK-ja po ashtu ka pasur tendenca të herëpashershme drejt së majtës. PDK-ja, më përpara e ka përkufizuar veten si social demokrate, dhe ka mbajtur lidhje me Partinë Laburiste (e Punës) të Mbretërisë së Bashkuar,[50] si dhe me Partinë Demokratike në SHBA.[51] PDK-ja ka shfaqur lidhje të ngushta me Partinë Socialiste të Shqipërisë, edhe pse nuk është shumë e qartë nëse kanë elemente të përbashkëta sa i përket disa çështjeve specifike të ideologjisë partiake. E gjetur nën kritikat e Lëvizjes Vetëvendosje (VV) për politikat e saj tatimore, PDK-ja e thekson historinë e politikave të saj që kanë kontribuar në ri-shpërndarjen e pasurisë dhe në

ndërtimin dhe renovimin e mbi njëqind shkollave dhe rrugëve.[52]

PDK-ja ka shfaqur tipare të ideologjive të kundërta. Në njërën anë, e mbështesin privatizimin e plotë të ndërmarrjeve publike, që është e qartë se i takon të djathtës, dhe në anën tjetër e posedon një administratë të madhe publike, gjë që është më shumë majtiste. Po ashtu, ajo shfaqet si majtiste edhe në rastin e subvencioneve për bujqësi, të cilat janë rritur dukshëm gjatë administrimit të PDK-së.

## LDK

Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) u krijua prej një grupi të intelektualëve në vitin 1989,[53] menjëherë pas ardhjes në pushtet të Slobodan Milosheviqit, i cili po e instalonte autoritetin e Serbisë mbi Kosovën dhe ia suprimoi autonominë e saj.[54] Ibrahim Rugova ishte themeluesi kryesor i saj, dhe ishte kryetar i partisë deri në vitin 2006, ndërsa tash ajo udhëhiqet prej Isa Mustafës.[55]

LDK-ja në spektrin politik zë vend kryesisht si parti e qendrës së djathtë, e cila është për një kombinim të liberalizmit ekonomik dhe konservatizmit social. Kjo demonstrohet përmes anëtarësimit të LDK-së në Partinë Popullore Evropiane (EPP), e cila e identifikon veten si "familja politike e qendrës së djathtë".[56]

Për LDK-në mund të thuhet se është pak më shumë liberale sesa partitë e qendrës së djathtë kur kemi të bëjmë me çështjet ekonomike. Në aspektin social, LDK-ja e përshkruan veten si konservatore, edhe pse mban pozicionim individualist në fushën e të drejtave të njeriut, duke e theksuar barazinë "pa marrë parasysh gjininë, moshën, përkatësinë etnike dhe fenë".[57] LDK-ja shihet si parti tradicionale që kontrollohet ende prej gjeneratës së vjetërve, të cilët janë në politikë tash e një kohë të gjatë. Kjo parti shihet edhe si tejet e ngurtë kur bëhet fjalë për reformimin e

saj të brendshëm dhe për tërheqjen e të rinjve.

LDK-ja e përkrah fuqishëm privatizimin e ndërmarrjeve publike, por, sikur partitë e tjera, nuk e ka kundërshtuar ofrimin pa pagesë të kujdesit shëndetësor.

## *AAK*

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) u themelua në maj të vitit 2000 nga Ramush Haradinaj, një ish-komandant i UÇK-së.[58] AAK-ja fillimisht ishte koalicion i pesë partive të veçanta, por kjo ndryshoi në vitin 2001 pasi dy parti dolën nga koalicioni, duke e lënë AAK-në të regjistrohet si subjekt i vetëm dhe i unifikuar.[59] Haradinaj kishte munguar në parti pas dorëheqjes në vitin 2005; dhe deri në kthimin e tij detyrat e kryetarit i kryente Blerim Shala, i cili tash i është kthyer rolit të tij si zëvendëskryetar.

AAK-ja konsiderohet po ashtu se i takon qendrës së djathtë. Në aspektin ekonomik, i përkrahin fuqishëm metodat e stimulimit të ekonomisë, si privatizimin e kompanive dhe zvogëlimi e tatimeve.[60]

## *VV*

Lëvizja Vetëvendosje (VV) u themelua në qershor të vitit 2005 si nismë qytetare me synim që të hynte në zgjedhjet parlamentare të vitit 2010. Albin Kurti e ka udhëhequr lëvizjen që prej vitit 2005, e cila shpesh mbështet procese dhe politika më radikale në krahasim me partitë e tjera. Për shembull, Kurti raportohet t'i ketë inkurajuar deputetët që të protestojnë në vend se të ndërmarrin ndonjë veprim përmes metodave parlamentare.[61] Kurti e sheh demokracinë përfaqësuese si të pamjaftueshme dhe e mbështet demokracinë e drejtpërdrejtë.[62]

Kur u pyet se si do ta përkufizonte partinë e tij, Kurti e përshkroi VV-në si të majtë ose të qendrës së majtë, por e theksoi faktin se për shkak të sistemit politik në Kosovë dhe

rrethanave aktuale, është vështirë që partitë të identifikohen me ideologji të caktuar. Në të vërtetë, kur kemi të bëjmë me politikat ekonomike, VV është më majtiste sesa partitë e tjera në Kosovë; ajo e përkrah një sistem ekonomik që krijon mundësi shoqërore për qytetarët.[63]

VV e kundërshton fuqishëm privatizimin, ndërsa është për një rol më të madh të shtetit në ekonomi, çka e vendos VV në spektrin e ideologjive majtiste. Së fundmi, VV-ja shfaqi pikëpamje interesante sa i përket çështjeve fetare, duke e përkrahur të drejtën e individëve për të mbajtur shami në shkollat publike.

Që prej themelimit të saj, VV-ja është pozicionuar kundër përfshirjes së drejtpërdrejtë të bashkësisë ndërkombëtare në jetën politike të Kosovës, si dhe kundër favoreve të dhëna pakicave etnike. Krahas idesë për bashkimin e Kosovës me Shqipërinë, qëndrimet e VV-së shihen nganjëherë jo vetëm si patriotike, por më shumë si ideologji nacionaliste.

# IV. Orientimi ideologjik një-dimensional dhe qëndrimet e partive për problemet specifike

Spektri politik është portretizuar përmes modeleve të ndryshme në kohë të ndryshme, duke filluar nga modeli një-dimensional i krijuar nga Parlamenti i pas Revolucionit të Francës[64], ku ulëset u organizuan sipas "krahut të majtë" dhe "krahut të djathtë". Ne e filluam studimin tonë nga spektri politik një-dimensional i majtë kah ai i djathtë, duke e përdorë shkallëzimin tradicional ekonomik dhe social.[65] Më poshtë e kemi paraqitur modelin social (M kah D, më pak liri individuale deri tek më shumë liri individuale) dhe modelin ekonomik (M kah D, ekonomi e kontrolluar deri te kapitalizëm i tregut të lirë).[66]




Një spektër tjetër një-dimensional është modeli ekonomik, të cilën e kemi marrë nga burimi i njëjtë. Në thelb, modelet dy-dimensionale vijnë si kombinim i këtyre dy modeleve. Pjesa tjetër e këtij seksioni merret me krahasimin e mesatareve të përgjigjeve nga secila parti sipas pyetjeve specifike. Ajo që na ka befasuar ishte se të gjitha partitë e tjera qëndronin pak a shumë në anën e majtë të qendrës.




## Shpërndarje e gjerë nga e majta drejt qendrës

Skena politike kosovare në përgjithësi zë vend në anën e majtë të qendrës sa i përket prioriteteve ekonomike dhe fiskale.



Vetëvendosja beson se taksat doganore dhe TVSH-ja duhet të rriten me qëllim që të shtohen të hyrat, të cilat do të kontribuonin për një ekonomi stabile. Zyrtarët e PDK-së besojnë se 10% e taksave doganore dhe 16% e TVSH-së janë të mjaftueshme, ndërsa LDK-ja dhe AAK-ja do të preferonin t'i ulnin tatimet në një kohë kur të stabilizohet ekonomia e Kosovës. Shumica e të anketuarve nga VV-ja ishin të mendimit se "një rritje e moderuar e TVSH-së do të përmirësonte ekonominë, dhe nga ana tjetër do të krijojë një standard më të lartë të jetesës". Partitë e tjera nuk ishin në favor të ngritjes mbi 16% të TVSH-së. PDK-ja ishte ndërmjet dy përgjigjeve me "ndoshta" (mu në qendër), ndërsa LDK-ja dhe AAK-ja ishin më afër përgjigjeve se "nuk duhet të merret parasysh rritja e taksave, dhe se duhet të krijohen të hyra shtesë vetëm përmes shkurtimit të shpenzimeve". Të gjitha partitë ishin për rritjen e akcizës, duke e tërhequr vëmendjen që mos të stimulohet kontrabanda si efekt anësor i kësaj rritjeje.



Sa i përket krijimit të vendeve të punës, shumica e partive me përgjigjet e tyre zinin pozicion pak në të majtë të qendrës se "sektori privat është kryesisht përgjegjës në këtë drejtim, por shteti duhet ta krijojë një ambient të përshtatshëm për këtë". Pjesa më e madhe e të anketuarve nga VV ishin të mendimit se shteti ka shumë më shumë përgjegjësi. Përgjigje të ngjashme u dhanë edhe kur u pyetën për tatimin progresiv, ku përsëri zinin vend në skajin e majtë i spektrit (me 5.9 të pikëve, që tregon preferencat politike për tatimimin e super të pasurve si mënyrë për luftimin e padrejtësive në klasat socio-ekonomike). Sa i përket pagës minimale, VV-ja ishte në favor të pagës minimale si për sektorin publik ashtu edhe për atë privat, e cila do t'ia mundësonte secilit një jetë të denjë. Tri partitë e tjera politike ishin më të moderuara dhe ishin në favor të asaj që ishte minimale e që e mundësonte ekzistencën. VV-ja ishte në favor të sindikatave të fuqishme punëtore, AAK në favor të sindikatave të fuqishme punëtore për sektorin publik, dhe më të dobëta për sektorin privat. LDK-ja dhe PDK-ja ishin thjesht për sindikata të punëtorëve, të cilat do t'i mbronin të drejtat e punëtorëve dhe sigurinë në vendin e punës, por jo për sindikata me fuqi të madhe lobuese.

## Mes ekonomisë dhe ndërkombëtarizimit

VV-ja ka shfaqur tendencat më majtiste pothuaj në të gjitha pyetjet ekonomike, të cilat i qëndrojnë besnike platformës së tyre partiake. Vetëvendosja është shprehur kundër shumicës së formave të privatizimit në Kosovë.






Tri partitë e tjera u shprehën për shumicën e formave, megjithëse LDK-ja shprehu ca rezerva vetëm për disa lloje të privatizimit (kryesisht për komercializimin dhe likuidimin).Ndryshe prej pjesës më të madhe të pyetjeve në anketë, privatizimi ka tërhequr më së shumti komente, dhe partitë kanë dhënë shumë deklarata për të. Për fat të keq, shumica e deklaratave kanë të bëjnë me abuzimin dhe korrupsionin lidhur me privatizimin, dhe ka shumë pak dallime ideologjike sa i përket privatizimit si politikë. Disa prej partive e mbështesnin privatizimin, jo për shkak se besojnë me të vërtetë në të, por si nevojë.[67] Zyrtarët e VV-së e shohin globalizimin kryesisht si forcë negative, megjithëse me disa aspekte pozitive. Tri partitë e tjera e shohin atë si pozitiv për shkak se e promovon diversitetin dhe transparencën.

Të gjitha partitë kanë shprehur qëndrime të favorshme për investimet dhe ndihmën nga jashtë. Përgjigja e Vetëvendosjes ishte më afër përgjigjeve të qendrës (të cilës ia kemi caktuar vlerën zero – "Pozitivisht: ndihma e kufizuar për sektorët e caktuar është thelbësore pasi Kosova nuk ka qasje tjetër në kapital"). Partitë e tjera renditeshin afër përgjigjes "Pozitivisht: por vetëm nëse shoqërohet me një ekonomi të brendshme të fortë". Të gjitha partitë u shprehën kundër përfshirjes ndërkombëtare në vendimmarrjet vendore, ndonëse me disa dallime të vogla. Vetëvendosja kishte qëndrimin më të fortë kundër kësaj, me besimin se "për të krijuar vendime të pavarura, qeveria e Kosovës nuk duhet të jetë e ndikuar nga komuniteti ndërkombëtar". Tri partitë e tjera u pajtuan se bashkësia ndërkombëtare nuk duhet të përfshihet në mënyrë aktive në vendimmarrje, megjithëse duhet të marrin pjesë duke ofruar shembuj krahasues. Sikur privatizimi, çështja e përfshirjes së të huajve ka nxitur debat, e që është normale për një vend i cili deri vonë ka qenë nën protektoratin ndërkombëtar. Ka shënuar rritje kundërshtimi ndaj përfshirjes ndërkombëtare në çështjet e brendshme, por në përgjithësi si dëshirë për të

treguar se Kosova është e aftë t'i udhëheq punët e veta, dhe të dëshmojë pjekurinë e shtetit.[68]

Kur u pyetën për shpenzimet publike për mbrojtje, VV-ja beson se Kosova duhet të shpenzojë shumë më shumë për mbrojtjen në mënyrë që të kultivohet krenaria dhe forca kombëtare. AAK-ja ishte në favor të më shumë shpenzimeve për mbrojtjen në mënyrë që të kemi një vend më të sigurt dhe më të qëndrueshëm. Edhe PDK-ja dhe LDK-ja ishin në favor të më shumë shpenzimeve në mbrojtje.







VV-ja u shpreh për mbështetje më të madhe për subvencionet, mes mesatares dhe të lartës, ndërsa të tjerët u shprehen për subvencionimin e mallrave kryesore. Edhe pse në këtë anketë, dy partitë kryesore janë treguar më pak entuziaste sa i përket subvencioneve, PDK-ja, megjithatë, i ka rritur vazhdimisht subvencionet (posaçërisht në bujqësi), ndërsa, në anën tjetër, edhe LDK-ja është zotuar se do ta bëjë të njëjtën gjë.






## Animi kah e majta

Pensionet dhe asistenca sociale kanë qenë një ndër elementet më të forta të Vetëvendosjes, dhe nuk është për t'u habitur që kanë mendim të ndryshëm, duke favorizuar një skemë më zemërgjerë sesa të tjerët. Ata nuk ishin të një mendimi rreth asaj se a duhet pasur një skeme publike dhe të detyrueshme të pensioneve, apo të lejojnë një skemë tjetër shtesë opsionale krahas asaj të detyrueshme publike (të cilën e kemi tani). Partitë e tjera anonin më shumë kah përgjigja e dytë. VV-ja besonte gjithashtu se duhej të rritej dukshëm asistenca sociale (nga aktualisht 40-80 euro) me qëllim që t'ju mundësohej qytetarëve një jetë normale. Partitë e tjera besonin se asistenca sociale duhej të mbetej tani për tani në nivelin aktual, dhe të rritej gradualisht.







## Rreshtimi i qartë dhe i kuptueshëm

Të gjitha partitë janë për integrimin evropian, edhe pse Vetëvendosja është më ngurruese në këtë drejtim. Vlerësimi i saj prej 1.6 pikësh është më afër përgjigjes "Kundërshtoj: BE pengon shoqërinë duke rregulluar politikën fiskale (merr një kompetencë nga Kuvendi jonë) por mbase nuk kemi zgjedhje". Përgjigja e partive të tjera (që sillen prej 4.3 deri 4.9) është më afër përgjigjes "E përkrah: Por vetëm nëse procesi i integrimit në BE bëhet më efikas, transparent dhe i hapur".







Të gjitha partitë janë për mbrojtjen e mjedisit, edhe pse kjo është në kundërshtim të plotë me politikat aktuale, ku i kushtohet shumë pak vëmendje prioriteteve mjedisore. Përgjigja e LDK-së qëndron mes përgjigjes se "duhet të financojmë programe të ndryshme si dhe duhet që më shumë burime të alokohen për mbrojtjen e mjedisit, të cilat eventualisht do ta shpaguajnë vetveten" dhe asaj të "ofrojmë ulje të taksave për ndotësit e vegjël, dhe të gjobisim ndotësit e mëdhenj". Përgjigja e tri partive të tjera qëndron një shkallë më lartë  dhe dallon midis "uljes së taksave për ndotësit e vegjël dhe gjobitjeve më të mëdha ndotësit e mëdhenj" dhe "nevojës për të pasur një legjislacion të avancuar që do t'i detyronte ndotësit t'iu përmbahen  standardeve të BE-së".







Të gjitha partitë duket se pajtohen në dy çështje, të cilat janë çuditërisht në kundërshtim me atë që ndodh në realitet. Të gjitha partitë që kanë qenë në pushtet kanë kontribuar që

Kosova të ketë një administratë publike të madhe (duke i punësuar me mijëra simpatizantë gjatë kohës sa kanë qenë në pushtet). Së paku në këtë anketë ata u treguan të vetëdijshëm dhe në mirëbesim shprehën mospajtimin e tyre lidhur me fryrjen e panevojshme të shërbimeve publike. VV-ja u shpreh për një zvogëlim të vogël të administratës publike, ndërsa AAK-ja me një zvogëlim shumë më të madh. Të gjitha partitë besojnë se duhet të zvogëlohet numri i ditëve të pushimit – LDK-ja dhe VV-ja besojnë se ditët e pushimit duhet të shkurtohen për një ditë, ndërsa PDK-ja dhe AAK-ja besojnë se duhet të shkurtohen për dy ditë.







Pati një rreshtim të qartë edhe sa i përket rritjes së shpenzimeve për kujdesin shëndetësor. VV-ja është e mendimit se duhet të rriten shumë shpenzimet publike, "cilësia dhe qasja në shërbimet e kujdesit shëndetësor duhet të jetë maksimale për të gjithë qytetarët në mënyrë të barabartë, dhe për ta arritur ketë duhet të rritet buxheti". LDK-ja dhe AAK-ja e favorizuan më shumë përgjigjen se "kujdesi shëndetësor është njëri nga programet më të rëndësishme të qeverisë në vend, dhe duhet një buxhet më i madh për të siguruar qasje të barabartë për të gjithë". PDK-ja ishte mes këtyre dy përgjigjeve. Sa i përket dilemës mes kujdesit publik dhe privat shëndetësor, LDK-ja dhe AAK-ja ishin të mendimit që "çdo individ ka të drejtën bazike për kujdes shëndetësor, dhe është përgjegjësi e qeverisë për të

ofruar shërbim të mirë, ndërsa të pasurit do mund të marrin shërbimin mjekësor privatisht.” PDK-ja, dhe në një farë mase edhe VV-ja, e favorizonin ofrimin e kujdesit shëndetësor me një kosto të ulët, dhe me një dozë kontrollit të qeverisë, ku më pak njerëz do të kishin nevojë të kërkonin kujdes privat shëndetësor.







Shumica e partive e vunë në rend të parë interesin kolektiv para atij individual, edhe pse në shkallë të ndryshme. Një pyetje tjetër nxori në pah më shumë nuanca sa i përket një dileme të ngjashme. Kur u pyetën se cilat institucione i shërbejnë më mirë ekonomisë së Kosovës, VV-ja i favorizoi institucionet publike “për t’u siguruar që institucionet e huaja nuk e dominojnë shoqërinë” ose “për të lejuar të mirat dhe shërbimet të jenë të shpërndara në mënyrë të barabartë përmes shoqërisë, duke eliminuar dallimet në klasa ekonomike”.







PDK qëndron mes dy përgjigjesh (paksa në favor të institucioneve publike me -1 pikë dhe paksa në favor të atyre

private me +1 pikë). LDK-ja dhe AAK-ja kanë treguar preferenca më të mëdha për aktivitetet private.

Ngurrimi ndaj mësimit fetar duket se i bashkon kosovarët e të gjitha shtresave. VV-ja e favorizon opsionin e lëndëve në të cilat i kushtojnë vëmendje të njëjtë të gjitha feve, ndërsa partitë e tjera ishin më pak të interesuara për ketë, duke anuar më shumë kah përgjigja se “edukimi fetar duhet të jetë pjesë e edukimit të përgjithshëm për vlerat shoqërore dhe se nuk duhet të jetë kurs i veçantë. Sa i përket pyetjes tjetër në lidhje me vijën ndarëse mes fesë dhe shtetit, të gjitha partitë silleshin rreth dy përgjigjeve, që lokacionet fetare duhet ta ulin zhurmën që e emetojnë, dhe se të drejtat fetare duhet të respektohen, por të mbesin çështje personale. AAK-ja[69] dhe LDK-ja ishin në mesin e partive të pakta që kishin një qëndrim më të zëshëm kundër shamisë, kundër mësimit fetar në shkollat publike, dhe për ndarjen e rreptë në mes fesë dhe shtetit.[70]

## Aspektet ndëretnike




Përderisa VV-ja gëzon imazhin si partia më nacionaliste, përfaqësuesit e saj kishin mendimet më miqësore për multi-

etnicitetin dhe marrëdhëniet etnike. Përgjigjet e VV-së ishin më liberalet, në të cilat shfaqej gatishmëria për të punuar me serbët e Kosovës, për të jetuar afër tyre por jo edhe për tu martuar me ta. Zyrtarët e AAK-së ishin më së paku të gatshëm për marrëdhënie ndëretnike, ku mesatarja e përgjigjeve theksonin se nuk e kanë problem të jetojnë afër serbëve të Kosovës, madje edhe të punonin me ta. Përgjigjet e LDK-së dhe PDK-së silleshin diku në mes.










VV-ja kishte më së paku dyshime sa i përket çështjes së multietnicitetit. Ata besonin që “multikulturalizmi duhet të mbrohet në të gjitha format, dhe se minoritetet nuk duhet të asimilohen”. AAK-ja kishte më së shumti dyshime nëse multietniciteti e dobëson apo e forcon shoqërinë kosovare.

Të gjitha partitë u shprehën kundër trajtimit preferencial. Shumica e tyre e mbështetën konstatimin se “trajtimi preferencial i minoriteteve është diskriminues për të tjerët.” Kërkesat e serbëve duhet të pakësohen me qëllimin që të jenë më të barabartë me të tjerët.

## Qëndrimi ndaj të këqijave të shoqërisë

PDK dhe VV treguan nivelin më të ulët të mostolerancës ndaj bixhozit, bastoreve, prostitucionit dhe drogës. AAK-ja dhe LDK-ja ishin në favor të trajtimit të këtyre të këqijave shoqërore si të jashtëligjshme dhe për ndjekjen penale të tyre. Mendimet më të ashpra ishin për drogën, ndërsa më të butat ishin për lojërat e fatit dhe bastoret. Sa i përket prostitucionit shumica e përgjigjeve silleshin rreth -5 pikëve që nënkupton “de-kriminalizimin e saj (trajtimin si kundërvajtje) dhe të dënohet me gjobë”.

## Liritë personale

VV-ja del të jetë më liberalja prej të gjitha partive kur kemi të bëjmë me liritë personale, mbase për shkak të moshës së re mesatare të zyrtarëve të saj kryesorë. Për shembull, përgjigjet e VV-së konsiderojnë që LGBT duhet të bëhet plotësisht e ligjshme dhe të promovohet, dhe për një të tretën e zyrtarëve të saj promovimi mund të përfshijë një paradë. Partitë e tjera preferonin që të drejtat e LGBT-së të mbesin të parregulluara dhe të toleroheshin, por pa i promovuar apo legalizuar në mënyrë eksplicite.



Zyrtarët e VV-së po ashtu besojnë se aborti duhet të mbetet i legalizuar, por jo të financohet nga paratë publike. Asnjë parti nuk është shprehur që aborti duhet të jetë i paligjshëm, por të tjerët treguan më pak gatishmëri për shpenzimin e fondeve publike për këtë qëllim. Janë matur katër tregues për të vlerësuar nëse të anketuarit ishin konservatorë apo liberalë. I pyetëm lidhur me preferencat sa i përket (a) numrit të fëmijëve, (b) qëndrimit ndaj divorcit, (c) qëndrimeve ndaj familjeve të mëdha, (d) kryerjen e marrëdhënieve seksuale para martesës, dhe (e) rolit të gruas në shtëpi. VV-ja doli të jetë më liberalja prej të gjithave, duke e favorizuar në përgjithësi një familje të vogël, duke mos shfaqur ndonjë shqetësim të madh ndaj divorcit apo seksit para martesës, si dhe duke preferuar rol të barabartë në familje. Edhe tri partitë e tjera duhet të konsiderohen liberale megjithëse në një shkallë dukshëm më të ulët.

Periudha e pushimit të lehonisë kohëve të fundit është zgjatur, duke nxitur një debat publik. VV-ja preferon që të zgjatet edhe më shumë pushimi i lehonisë (në 12 muaj dhe me pagesë të plotë për së paku 9 muaj). Partitë e tjera besonin se pushimi i lehonisë duhet të jetë 9 muaj, dhe të paguhet nga punëdhënësi privat për 6 muaj. Në përgjithësi, gjatë debateve publike janë ngritur shqetësime që kanë të bëjnë me rënien e shkallës së lindjeve[71], ndërsa të tjerët e konsideronin diskriminuese faktin që tremujori i tretë i nëntëmujorit të pushimit të lehonisë të mos paguhet.[72]



Kosova nuk përballet me sfidën e imigracionit; në fakt ajo ende është një vend që eksporton emigrantë. Sidoqoftë, e konsideruam të nevojshme ta bënim pyetjen lidhur me ketë, edhe pse asaj i dhamë një peshë mjaft të ulët në vlerësimin e përgjithshëm. Meqë kjo nuk është çështje ekonomike, ajo mund të jetë më me rëndësi për vlerësimin e qëndrimeve liberale, ku VV-ja u tregua më e hapur, ndërsa partitë e tjera ishin më pak të hapura, gjë që është në përputhje me përgjigjet e tjera sa i përket lirive personale.

AAK dhe LDK favorizuan një preferencë më të madhe për tradicionalen (më afër pikëve prej -4 se "tradita duhet të kultivohet me fonde publike" dhe "0" "tradita dhe modernja duhet të balancohen me kujdes". PDK dhe VV anonin paksa më shumë kah modernja.

Të gjitha partitë pothuaj kishin përgjigje të njëjta sa i përket shoqërisë civile, të cilat silleshin mes përgjigjes se "roli i shoqërisë civile nuk është shumë efektiv, ka shumë vend për përmirësime" (-1) dhe se "shoqëria civile duhet të vazhdojë të jetë e inkurajuar, pasi krijon një komunitet më të përfshirë" (+1).

## V. Shpërndarja e përgjigjeve

Tabela në faqen në vijim paraqet devijimin standard të secilës përgjigje, si mënyrë për të matur shpërndarjen e përgjigjeve në tabelë sipas çështjes së adresuar dhe sipas partisë. Kështu, shkalla e shpërndarjes së përgjigjeve tregon se çështja e adresuar është më kundërthënëse brenda partisë. Kjo nuk do të thotë se partitë nuk duhet t'i diskutojnë këto tema, përkundrazi, për temat për të cilat në të kaluarën ka pasur diskutime të shumta publike kishte konsensus me të madh.

Më pak kundërthënie kishte për temat si pushimi i lehonisë, detyrimet doganore, investimet dhe ndihmat nga jashtë (që gjenden në krye të listës). Këto janë çështje për të cilat përgjigjet ishin pak a shumë të njëjta. Dallime më të mëdha në përgjigjeve i gjejmë për çështjet që kanë të bëjnë me prostitucionin, bixhozin dhe bastoret, dhe abortin. Për këto tri pyetje, të anketuarit kanë dhënë përgjigje që janë mjaft kundërthënëse brenda grupit.

Është me rëndësi të theksohet se çështjet për të cilat përgjigjet janë më pak të shpërndara janë diskutuar mjaft shumë në publik, andaj kemi një përafrim të qëndrimeve. Në pjesën e poshtme të tabelës janë çështjet të cilat nuk janë diskutuar aq shumë, dhe për të cilat pritet të ketë shumë debate në të ardhmen.

Vetëvendosja duket se e ka shkallën më të lartë të homogjenitetit në qëndrime, me një mesatare të devijimit standard prej 3.9, ndërsa partitë e tjera luhaten mes 5 dhe 5.1.

| | Devijimi standard | VV | LDK | PDK | AAK | Mes |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Detyrimet doganore | 3.7 | 2.8 | 3.0 | 3.8 | 3.3 |
| 2 | Pushimi i lehonisë | 2.0 | 4.1 | 3.9 | 3.9 | 3.5 |
| 3 | Private kundrejt publike | 3.2 | 5.1 | 1.9 | 4.6 | 3.7 |
| 4 | Tatimi i sheshtë apo progresiv | 1.4 | 4.4 | 4.0 | 5.7 | 3.9 |
| 5 | Niveli i shpenzimeve publike për mbrojtje | 3.1 | 4.6 | 3.7 | 4.6 | 4.0 |
| 6 | Shpenzimet publike për kujdesin shëndetësor | 1.4 | 3.8 | 5.9 | 5.0 | 4.0 |
| 7 | Rregullimi i tregtisë | 2.5 | 5.4 | 3.4 | 5.8 | 4.3 |
| 8 | Mjedisi | 2.2 | 5.0 | 5.9 | 4.1 | 4.3 |
| 9 | Investimet dhe ndihmat e huaja | 2.7 | 4.7 | 4.4 | 5.5 | 4.3 |
| 10 | Subvencionet në bujqësi | 5.5 | 3.6 | 2.9 | 5.4 | 4.3 |
| 11 | Ofrimi i kujdesit shëndetësor privat vs publik | 2.6 | 4.6 | 6.0 | 4.2 | 4.3 |
| 12 | Mësimi për fenë | 2.3 | 5.9 | 4.2 | 5.1 | 4.4 |
| 13 | Trajtimi preferencial i pakicave | 3.7 | 4.5 | 4.5 | 4.9 | 4.4 |
| 14 | Përfshirja e bashkësisë ndërkombëtare në vendimma | 3.2 | 4.2 | 6.4 | 3.8 | 4.4 |
| 15 | Shoqëria civile | 4.2 | 3.6 | 5.3 | 4.7 | 4.4 |
| 16 | Sindikatat e punëtorëve | 3.3 | 5.1 | 4.3 | 5.4 | 4.5 |
| 17 | Madhësia e administratës publike | 4.2 | 5.0 | 4.2 | 4.9 | 4.5 |
| 18 | Tatimi mbi vlerën e shtuar | 4.9 | 4.6 | 3.9 | 4.8 | 4.5 |
| 19 | Feja vs shteti | 2.9 | 5.3 | 5.7 | 4.2 | 4.5 |
| 20 | Drogat | 4.9 | 4.8 | 5.5 | 3.6 | 4.7 |
| 21 | Marrëdhëniet ndëretnike | 3.4 | 4.2 | 6.2 | 4.9 | 4.7 |
| 22 | Integrimi evropian | 4.0 | 4.6 | 5.9 | 4.4 | 4.7 |
| 23 | Globalizimi | 5.0 | 4.1 | 5.7 | 4.4 | 4.8 |
| 24 | Imigracioni | 3.8 | 4.8 | 4.8 | 6.0 | 4.9 |
| 25 | Interesi individual *vs* kolektiv | 3.8 | 5.3 | 5.4 | 5.2 | 5.0 |
| 26 | Kultura dhe tradita | 4.1 | 4.9 | 6.5 | 4.4 | 5.0 |
| 27 | Vlerat e familjes | 2.5 | 5.8 | 5.7 | 6.0 | 5.0 |
| 28 | Subvencionet | 3.9 | 5.3 | 4.8 | 6.1 | 5.0 |
| 29 | LGBT | 5.8 | 4.3 | 4.5 | 5.5 | 5.0 |
| 30 | Pushimet dhe festat zyrtare | 6.4 | 4.4 | 4.6 | 5.6 | 5.3 |
| 31 | Asistenca sociale | 3.8 | 6.3 | 5.4 | 5.7 | 5.3 |
| 32 | Pensionet | 5.0 | 4.6 | 6.5 | 5.1 | 5.3 |
| 33 | Krijimi i vendeve të punës | 4.4 | 5.5 | 6.6 | 4.9 | 5.3 |
| 34 | Paga minimale | 2.4 | 5.9 | 5.8 | 7.9 | 5.5 |
| 35 | Akciza | 5.9 | 5.3 | 6.3 | 4.7 | 5.5 |
| 36 | Multi-etniciteti | 7.5 | 5.1 | 4.9 | 5.4 | 5.7 |
| 37 | Privatizimi | 2.0 | 6.9 | 7.9 | 6.5 | 5.8 |
| 38 | Prostitucioni | 5.0 | 7.1 | 6.4 | 5.2 | 5.9 |
| 39 | Legalizimi dhe kostoja e abortit | 7.5 | 7.1 | 3.9 | 7.2 | 6.4 |
| 40 | Bixhozi dhe bastoret | 6.3 | 7.0 | 6.4 | 6.8 | 6.6 |
| | **Mesatarja për secilën parti** | 3.9 | 5.0 | 5.1 | 5.1 | |

# VI. Kategorizimi i partive

Njëra prej kategorizimeve dy-dimensionale të cilës i referohemi më së shumti quhet diagrami i Nolanit[73], një diagram ideologjik i krijuar nga politikani amerikan David Nolan. Diagrami i ndan mendimet politike të njerëzve në dy vektorë: liria ekonomike dhe liria personale, e cila prodhon një diagram dy-dimensional, kartezian, të ideologjive politike. Kjo e mundëson paraqitjen vizuale të pikëpamjeve, si p.sh, perspektivën libertariane (liri e madhe personale dhe ekonomike), dhe perspektivën totalitare (liri e vogël personale dhe ekonomike). Ajo e shpalos më shumë shkallën mes "të majtës dhe të djathtës", e cila përpiqej të maste politikën në aspektin një-dimensional.

Një model tjetër që gjen përdorim mjaft të shpeshtë njihet si kompasi politik apo orientimi politik.[74] Ngjashëm me diagramin e Nolanit, modeli i kompasit politik po ashtu përbëhet nga shumë boshte, si dhe trajton edhe anën sociale dhe ekonomike. Megjithatë, kompasi politik i radhit ideologjitë si e majtë/e djathë dhe autoritare/libertariane. Modeli u krijua prej një faqe të njohur britanike të internetit me emrin "Pace News Limited[75]", dhe është përdor në studime të ndryshme të shkencave politike.




Modeli ynë i preferuar, të cilin e kemi përdor për qëllime krahasuese/orientuese, është ai i Diagramit Alternativ të Nolan-it[76]. Ky version i diagramit bën që skica të lëviz në formë rotacioni në mënyrë që vektorët për liritë ekonomike dhe personale të paraqesin liri më të madhe në krye të diagramit, dhe liri më të vogël në fund të tij. E majta ekstreme dhe e djathta ekstreme paraqiten në të majtë dhe në të djathtë, përkatësisht, ndërsa ideologjia libertariane është në krye, dhe ajo statiste në fund. Për nevoja të studimit tonë, ne kemi modifikuar një version të diagramit alternativ të Nolan-it, dhe e kemi përpiluar pyetësorin sipas tij.

Në këtë seksion kemi paraqitur të gjeturat e anketës, këtë

herë në format dy-dimensional, për partitë veç e veç. Boshti x paraqet pyetjet që kishin të bënin me çështjet ekonomike, ndërsa boshti y i paraqet përgjigjet për vlerat.




Secila pikë në diagram përfaqëson një individ të anketuar, i cili ishte në pozitë relativisht të lartë në një prej katër partive më të mëdha në Kosovë. Diagrami pasqyron të gjeturat që burojnë nga 160 intervistave, 40 nga secila parti.

## PDK

Duke iu referuar diagramit në faqen në vijim del se rezultatet tregojnë një shpërndarje të drejtë ideologjike, ku mendimet shtrihen në të dy aspektet e orientimit, atij ekonomik (boshti x) dhe të vlerave (boshti y). Për ta kuptuar më mirë një shpërndarje të tillë ideologjike duhet të ndahen kategoritë brenda sistemit ekonomik dhe atij të vlerave. Opinionet e shumicës së zyrtarëve të PDK-së paraqiten të shpërndara gjithandej spektrit ideologjik, çka edhe pritet prej një partie me gjithëpërfshirëse, e cila është partneri kryesor koalicionit qeverisës.

Sa i përket çështjeve ekonomike, më shumë se gjysma e PDK-së gjendet në të majtë të qendrës, dhe më pak se gjysma në të djathtë të qendrës. Të anketuarit që identifikohen me të majtën kanë shfaqur simpati për rolin e qeverisë në rregullimin e tregut dhe doganave, dhe në krijimin e vendeve të punës për një ekonomi të shëndetshme. Ata që anojnë kah e djathta tregojnë mbështetje për ekonominë e privatizuar, e cila është më efektive, si dhe për një politikë fiskale, e cila e promovon zvogëlimin e tatimeve për një mjedis më të mirë afarist. Globalizimi shihet në përgjithësi si një forcë pozitive, por në disa raste mund të ketë ndikim negativ, posaçërisht, në ekonomi. Për më tepër, të anketuarit nga radhët e PDK-së besojnë se politikat shëndetësore duhet të jenë pa pagesë ose me kosto të ulët, ndërsa shteti duhet ta mbështes më shumë kujdesin shëndetësor nga buxheti.

Sa i përket vlerave kryesore sociale/politike, më shumë se gjysma e të anketuarave nga PDK-ja kanë shfaqur orientim konservator, dhe më pak se gjysma e tyre kanë shfaqur vlera liberale, pra janë mbi vijën ndarëse në mes. Për shembull, ata besojnë se të drejtat e komunitetit LGBT duhet të mbesin private dhe të mos promovohen publikisht.

...


E djathta
Ekonomia
E majta
Liberal
Konservator

Tek PDK janë vërejtur pikëpamje më konservatore sa i përket çështjes së pakicave dhe prostitucionit. Ata nuk besojnë që qeveria duhet të ndërmarrë veprim afirmativ për institucionalizimin e kuotave për pakicat gjatë punësimit në sektorin publik – të gjithë njerëzit që konkurrojnë për punë duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë. Në ndërkohë, sa i përket prostitucionit, shumica prej tyre e shohin atë si kundërvajtje që duhet të dënohet.

Gjithashtu është me rëndësi të shohim shpërndarjen e përgjigjeve brenda partisë. PDK-ja ka shpërndarjen më të ulët sa i përket pyetjeve në fillim të tabelës në të djathtë, si për subvencionet në bujqësi ose për

| Devijimi standard | PDK |
|---|---|
| Private kundrejt publike | 1.9 |
| Subvencionet në bujqësi | 2.9 |
| Detyrimet doganore | 3.0 |
| Rregullimi i tregtisë | 3.4 |
| Niveli i shpenzimeve publike për mbrojtje | 3.7 |
| Legalizimi dhe kostoja e abortit | 3.9 |
| Tatimi mbi vlerën e shtuar | 3.9 |
| Pushimi i lehonisë | 3.9 |
| Tatimi i sheshtë ose progresiv | 4.0 |
| Madhësia e administratës publike | 4.2 |
| Mësimi për fenë | 4.2 |
| Sindikatat e punës | 4.3 |
| Investimet dhe ndihmat e huaja | 4.4 |
| Trajtimi preferencial i pakicave | 4.5 |
| LGBT | 4.5 |
| Pushimet dhe festat zyrtare | 4.6 |
| Subvencionet | 4.8 |
| Imigracioni | 4.8 |
| Shumë etnia | 4.9 |
| Shoqëria civile | 5.3 |
| Asistenca sociale | 5.4 |
| Interesi individual kundrejt atij kolektiv | 5.4 |
| Narkotikët | 5.5 |
| Globalizimi | 5.7 |
| Vlerat e familjes | 5.7 |
